

**INTEGRIMI I TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT
NË EDUKIM NË SHQIPËRI**

FALËNDERIME:

Falënderojmë Fondacion Shoqëria e Hapur (SOROS) i cili bëri të mundur realizimin e kësaj iniciative, Ministrin e Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj, Ministrin e Inovacioni Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Z. Genc Pollo, Drejtoreshën e Drejtorisë së “E-edukimit” dhe statistikave në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Znj. Ardiana Sula, Drejtorin e Departamentit Shqipëria Dixhitale, në Ministrinë e Inovacionit Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Z. Sidrit Malevi, Drejtoreshën e Departamentit të Metodologjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie, në Institutin e Zhvillimit të Arsimit, Zj. Irida Sina, Drejtoreshën Shkollës së mesme të përgjithshme “Sami Frashëri”, Znj. Julinda Minarolli, Përgjegjësin e Sektorit të “E-edukimit”, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Z. Sokol Ymeri, si dhe partnerët tonë kryesor në këtë iniciativë, “e-Governance Academy” në Estoni dhe Fondacionin “Metamorphosis” në Maqedoni, pa angazhimin e të cilëve ky projekt nuk mund të arrinte qëllimin e kërkuar për shkëmbimin e eksperiencave dhe huazimin e praktikave më të mira me qëllim zhvillimin e T.I.K në fushën e arsimit.

TË NDERUAR LEXUES!

Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) është një organizatë me karakter shkencor, kërkimor, profesional, kulturor, e pavarur, joqeveritare dhe jopolitike, i cili me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros po zbaton iniciativën me temë: “Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit në sistemin arsimor në Shqipëri dhe eksperiencia e vendeve të tjera”.

Realizimi i kësaj iniciativë është bërë i mundur nëpërmjet mbështetjes së Fondacionit Shoqëria e Hapur (Soros) në kuadër të programit *East East Beyond Borders*, i cili është një program që mbështet iniciativat të organizatave të shoqërisë civile të dy ose më shumë vendeve më qëllim bashkëpunimin dhe shkëmbimin e eksperiencave të bazuar në shkëmbimin e informacionit dhe inovacionin.

Duke qenë se edukimi bashkëkohor në rritjen e aftësive për qytetarët Shqiptarë, ka një rëndësi të veçantë është vlerësuar se zhvillimi i nivelit arsimor në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare është një pjesë përbërëse e prioritetit kombëtar. Në vendin tonë është përcaktuar si një nga prioritetet kryesore përmirësimi i sistemit shkollor. Me masat e ndërmarra deri më tani është synuar modernizimi i sistemit arsimor dhe bërja e tij më efikas dhe produktiv për tregun dhe për vendin nëpërmjet integritit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Qëllimi i këtij projekti ka qenë rritja e efektivitetit të përdorimit të T.I.K në proceset mësimore nëpërmjet shkëmbimit të mëtejshëm të eksperiencave me vende si Estonia dhe Maqedonia, të cilat kanë pasur praktikën më të mirë të aplikimit të “E- shkolla” / “E-edukimit”. Nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës është synuar perfeksionimi i praktikave të cilat do të ndiqen në të ardhmen për hartimin e politikave dhe strategjive të nevojshme me synim integrimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në procesin e mësimdhënies dhe të mësim-nxënies në të gjithë sistemin arsimor.

Në këtë kuadër, në këtë dokument do të gjeni një informacion të përmbledhur, mbi situatën aktuale në vendin tonë mbi aplikimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në sistemin arsimor si dhe njëkohësisht sfidat e mëtejshme që mund të përballen në të ardhmen aktorët e interesuar në këtë fushë në kuadër të integritit TIK në proceset e mësimdhënies dhe mësim-nxënies.

Lexim të këndshëm.

APLIKIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHQIPËRI DHE NË EDUKIM NË VEÇANTI.

Në fund të vitit 2009 ka përfunduar projekti “e-shkolla”, i cili plotësoi disa objektiva: (i) Pajisi shkollat e mesme dhe 9 vjeçare me laborator kompjuterik; (ii) Lidhi me internet bande-gjerë këto laboratorë; (iii) Trajnoi mësuesit e TIK në gjithë Shqipërinë; (iv) Filloi përmirësimin e kurrikulave të TIK.

Qëllimi kryesor i Programit të “e-shkolla”, ka qenë mundësimi i lidhjes me Internetin të shkollave publike nëntë vjeçare dhe të mesme, pajisja e tyre me laboratorë kompjuterësh, si dhe trajnimi i mësueseve për t’i menaxhuar ato dhe për të dhënë mësim me një kurrikulum bashkëkohor. Objektivi kryesor i këtij programi ka qenë krijimi i një ambienti në të cilin nxënësit, si në zonat rurale dhe ato urbane të mund të mësojnë përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit.

Këto nisma kanë pasur si qëllim dhe trajnimin e mësuesve dhe trajnerëve në bazat e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, përdorimit të kompjuterit dhe aplikacioneve të tij, bazat e punës në Internet dhe njohuri bazë për mirëmbajtjen. Njohja me metodologjitë e mësimdhënies nëpërmjet Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, i ka mundësuar mësuesve dhe nxënësve të përmirësojnë procesin mësimor në të gjitha lëndët, si dhe përvetësimi në një nivel të mjaftueshëm të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit, i ka lejuar nxënësit të kualifikohen për përdorimin e kompjuterit deri në fund të shkollës së mesme. Megjithatë, pavarësisht se aktualisht nëpër shkolla ka kompjuter dhe internet, ka vend për përmirësime të mëtejshme. Është mirë që të kalohet në një stad të ri të bashkëpunimit, ndarjes së eksperiencave, si dhe zhvillimin e procesit të mësimdhënies nga sistemi “E-shkolla” në atë të edukimit, “E-Edukimi”.

1. PËRDORIMI TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKACIONIT (TIK) NË SISTEMIN ARSIMOR.

Në dhjetor të vitit 2005 nga ana e qeverisë shqiptare është prezantuar Master Plani për programin “e-shkolla”. Ky program i ndërmarrë nga Qeveria ka bërë të mundur informatizimin e shkollave, futjen në edukimin e nxënësve të shkollave 9-vjecare dhe të mesme të njohurive dhe përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikacionit.

Në kuadër të zhvillimit të procesit të integrit të T.I.K janë realizuar një sërë procesesh si dhe janë marrë një sërë masash në disa drejtime si aplikimi i lëndës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në arsimin bazë. Prej vitit 2007 kjo lëndë zhvillohet nga klasa e shtatë deri në klasën e dymbëdhjetë. Në të njëjtën kohë, është synuar rishikimi i kurrikulës me qëllim përshtatjen e saj me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe përveç përmirësimit të infrastrukturës nëpërmjet krijimit të kabineteve, shkollat janë pajisur dhe me laptop, projektor dixhital si dhe me CD me përmbajtje multimediale që përdoret në lëndë të ndryshme.

2. PLANIFIKIMI STRATEGJIK.

Për sa i përket procesit të planifikimit strategjik vlerësohet se Shqipëria ka hartuar dhe po zbaton **Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2009-2013** e cila parashtron synime dhe objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm për sistemin dhe paraqet politikat për prioritetet strategjike për vitet që pasojnë deri në vitin 2013. Kjo strategji përfshin arsimin parashkollor, arsimin parësor dhe dytësor, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional. Në kuadër të kësaj strategjie janë parashikuar një sërë politikash dhe masash konkrete të cilat duhet të ndërmerren nga ana e institucioneve përgjegjëse në kuadër të aplikimit Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikacionit në sistemin arsimor. Ky proces është synuar të fokusohet kryesisht:

- *Zhvillimin e përmbajtjeve dixhitale mësimore dhe i materialeve multimediale;*
- *Pajisjen e shkollave me laboratorë të lëvizshëm dhe programe aplikative me qëllim përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së mësimdhënies;*
- *Integrimin e TIK-ut në lëndët e ndryshme të kurrikulës shkollore;*
- *Vijimin me përmirësimin e shërbimit të internetit në të gjithë shkollat dhe përdorimi i tij në arsim si një mjet burimor për materiale mësimore nga të gjithë nxënësit dhe mësuesit;*
- *Krijimin e kapaciteteve të nevojshme nëpërmjet trajnimit të vijueshëm të të gjithë mësuesve të arsimin parauniversitar do të shërbejë si bazë që ata të jenë familjar në përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënies.*

Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin e saj për të ecur drejt rrugës së funksionimit të një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe krijimin e një shoqërie të informacionit. Në vitet e fundit është bërë një progres i ndjeshëm, në drejtim të qeverisjes elektronike. Po kështu është rritur edhe ndërgjegjësimi për përfitimet nga teknologjia e informacionit dhe shkalla e përdorimit të internetit nga qytetaret sidomos për brezin e ri. Në këtë kuadër është hartuar

Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013, e cila mbështetet në modelet dhe praktikat më të mira evropiane, përse i përket objektivave dhe zgjidhjeve të parashikuara, gjithnjë duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të shoqërisë shqiptare.

Qëllimi i kësaj strategjie është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për krijimin e shoqërisë së informacionit me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar. Strategjia konsideron si faktor kyç të suksesit për formimin dhe zhvillimin e shoqërisë së informacionit rritjen e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe shikon zhvillimin e infrastrukturës për teknologjinë e informacionit si çelësin e zbatimit të suksesshëm të saj.

Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013 janë hartuar dhe janë marrë përsipër një sërë objektivash dhe masash mbi aplikimin e TIK në sistemin arsimor. Në zbatim të qëllimit të mësipërm në strategji janë përcaktuar fushat prioritare bashkë me objektivat e përgjithshëm që synohen të arrihen. Një nga fushat prioritare është dhe edukimi. Në kuadër të kësaj strategjie, janë hartuar një sërë objektivash të cilat fokusohen në:

- *Përmirësimin e infrastrukturës TIK në arsim;*
- *Aplikimi on-line për sistemin Universitar;*
- *Integrimin i TIK në mësimdhënie/mësimnxënie;*
- *Implementimi i kurrikulës së re të rishikuar TIK për klasat 1-12;*
- *Reformimi i kurrikulës së arsimit bazë 1-9, për integrimin e TIK-ut duke filluar nga arsimi bazë, dhe si metodologji mësimdhënie në klasat e para të edukimit;*
- *Hartimi i standardeve të TIK-ut për nxënësit, mësuesit, dhe administratorët e shkollave;*
- *Përcaktimi i skemave/standardeve të përgatitjes/certifikimit të Specialistit të Teknologjisë në Edukim;*
- *Zhvillimi i përmbajtjes on-line (biblioteka dixhitale).*

Përmirësimi i infrastrukturës TIK në arsim ka konsistuar në parashikimin e masave lidhur me rritjen e shpejtësisë së aksesit Internet në shkolla dhe cilësisë së shërbimit. Në të njëjtën kohë është synuar shtimi i laboratorëve të informatikës, si dhe pajisja me laptopë e mësuesve të informatikës dhe pajisja me laptopë dhe projektorë e klasave të sistemit para-universitar. Krahas krijimit të bazës materiale janë konceptuar dhe një sërë masash në lidhje me pajisjen me laboratorë për mësimin e gjuhëve të huaja, si dhe pilotimi i teknologjive arsimore në disa shkolla.

Në kuadër të aplikimit on-line për sistemin universitar, janë parashikuar një sërë masash të cilat synojnë aplikimin on-line të formularit A2 për sistemin e Maturës Shtetërore dhe pranimit në institucionet e arsimit të lartë.

Gjithashtu, në kuadër të integrit të TIK në sistemin arsimor në përgjithësi, në mësimdhënie/mësimnxënie, si dhe në zhvillimin dhe aplikimin e standardeve të TIK-ut për nxënësit, mësuesit, dhe administratorët e shkollave, janë marrë një sërë masash. Këto masa kanë konsistuar në disa drejtime dhe konkretisht:

- *në sistemin e menaxhimit arsimor;*
- *infrastruktura fizike;*
- *kualifikimi i mësuesve;*
- *zhvillimi i kurrikulës TIK në arsimin parauniversitar;*
- *burimet alternative të mësimdhënies.*

3. SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT NË SEKTORIN E ARSIMIT (EMIS).

Për sa i përket sistemit të menaxhimit arsimor, vlerësohet se rritja e produktivitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit arsimor ka ardhur si pasojë e pajisjes dhe përdorimit efektiv të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjithë sistemin tonë arsimor. Kjo do të thotë kompjuterizim i proceseve që lidhen me kryerjen e detyrave administrative të përditshme dhe specifikisht i shkëmbimit të informacionit arsimor midis niveleve të ndryshme. Synimi i këtij sistemi është krijimi i bazave të dhënave arsimore dhe i një harte shkollore të dixhitalizuar për një planifikim efektiv arsimor dhe zhvillim politikash dhe vendimmarrjesh arsimore të përshtatshme. Këto masa fokusohen në përmirësimin dhe modernizimin infrastrukturës teknologjike në të tre nivelet, shkollë, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe ministri dhe zhvillimit të një sistemi informacioni të besueshëm, të shpejtë dhe të saktë.

Në këtë kuadër është krijuar dhe Sistemi Menaxhimi Informacionit Parauniversitar (SMIP), i cili përmban bazën e të dhënave të nxënësve të sistemit parauniversitar, së bashku me një numër identifikues unik (Amza) dhe notat e certifikatave gjashtëmujore. Përveç kësaj sistemi ka bazën e të dhënave të mësuesve të sistemit parauniversitar arsimor me informacionin përkatës të kualifikimeve (certifikatat, trajnimet) të tyre si dhe nivelin arsimor (diplomat, titujt akademik).

Gjithashtu është krijuar baza e të dhënave elektronike e arsimit të lartë që përfshin Regjistrin Kombëtar të Studentëve, ku çdo student i regjistruar në çdo universitet publik apo privat do të ketë numrin e tij kombëtar të identifikimit (matrikulla), pavarësisht numrit përkatës të cilin mund të ketë marrë në universitetin në të cilin po ushtron studimet . Kjo bazë të dhënash do të përbëhet nga katër module: (i) moduli e studentit; (ii) moduli i stafit akademik; (iii) moduli i njohjes së diplomave; si dhe (iv) moduli i statistikave.

Sistemi Informativ Gjeografik (GIS), do të ndihmojë strukturat vendimarrëse për arsimin dhe autoritetet e pushtetit vendor në lidhje me sistemin arsimor, si pozicionimin gjeografik të objekteve shkollore arsimore dhe nevojat e tyre. Ndërsa Sistemi i Menaxhimit të Infrastrukturës së Shkollave (SIMS) është një aplikim i bazuar në rrjet, që përmban të dhëna në lidhje me infrastrukturën shkollore në Shqipëri. Integrimi i këtyre dy moduleve ofron për vendim-marrësit një mundësi reale për të orientuar politikën e tyre në lidhje me investimet buxhetore, nevojat për mirëmbajtjen e shkollave, si dhe bazën e të dhënave.


Moduli financiar menaxhon financat dhe buxhetet e institucioneve të arsimit në nivel qendror dhe lokal, MASH dhe DAR/ZA. Sistemi është duke u ndërtuar në një platformë unike bazë së të dhënave qendrore, si dhe synon rritjen e cilësisë së ndërveprimit dhe shmang dublimin e informacionit (të dhënave). Përveç kësaj sistemi rrit në nivel maksimal dhe transparencën e shpenzimeve.

Në të njëjtën kohë vlen të theksohet se pjesë e këtij sistemi është dhe Matura Shtetërore. Aplikimi on-line i Maturës Shtetërore është një sukses dhe aktualisht nëpërmjet këtij sistemi, studentët mund të plotësojnë on-line formularin A2. Gjithashtu sistemi për provimet e shtetit për profesionet e rregulluara në Shqipëri është plotësisht funksional dhe gjatë vitit 2012 janë kryer me sukses të dy sezone të provimeve shtetërore.


4. INFRASTRUKTURA FIZIKE

Në kuadër të zhvillimit të procesit të integritit të T.I.K në arsim gjatë viteve të fundit janë marrë një sërë masash, si dhe janë kryer një sërë investimesh në infrastrukturën fizike të institucioneve arsimore. Në këto kushte vlen të theksohet se aktualisht janë ndërtuar 1496 laboratorë kompjuterikë (Grafiku 1), me një numër total prej 24.125 kompjuterë personal (Grafiku 2).


Të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar janë pajisur me kompjuter dhe laptop për të zhvilluar lëndën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe raporti kompjuter për nxënës është 1 kompjuter për 21 nxënës krahasuar me vitin 2005 ku raporti ishte 1 kompjuter për 376 nxënës. Në të njëjtën kohë vlen të theksohet se raporti kompjuter/100 nxënës është 4.65 (Grafiku 3).



Grafiku1: Numri total i laboratorëve




Grafiku 2: Numri total i kompjuterëve



Grafiku 3: Raporti kompjuter për 100 nxënës

Të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar janë lidhur me linja të dedikuara Interneti dhe përfitojnë shërbim Interneti me brez të gjerë. Çdo shkollë ka një lidhje *broad-band* me shpejtësi të dedikuar minimale 1024/256 Kbps (Grafiku 4). Rrjeti i internetit është instaluar në shkolla për të bërë të mundur për mësuesit dhe nxënësit shfrytëzimin e burimeve informative të ndryshme, si dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies dhe të nxënës, nëpërmjet aplikimit të teknologjive të reja në arsim.




Grafiku 4: Numri i shkollave me internet.

5. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE DHE DREJTUESVE TË SHKOLLAVE PËR PËRDORIMIN DHE INTEGRIMIN E T.I.K.

Për sa i zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për përdorimin dhe integrimin e T.I.K, vlerësohet ky proces ka pësuar rritje të vazhdueshme. Në funksion të qëllimit për integrimin e TIK në edukim gjatë viteve të fundit është synuar që mësuesit të jenë pajisur me aftësitë bazë të TIK. Është synuar që të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet integrimit dhe të përdorimit të gjerë të TIK në procesin e mësimdhënies. Janë zhvilluar standardet e TIK për mësuesit dhe administratorët e shkollave si dhe të gjithë mësuesit të cilët zhvillojnë lëndën e TIK, janë trajnuar.

Për sa i përket trajnime vlen të theksohet se janë trajnuar 2000 mësues të profilit shkencor dhe të profilit social për përdorimin dhe integrimin e TIK në arsim. Janë trajnuar të gjithë mësuesit (në masën 100 %) të cilët zhvillojnë lëndën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe numri total i mësuesve të trajnuar është 4484. Krahas mësuesve, gjithashtu janë trajnuar dhe 500 administrator të shkollave mbi aplikimin dhe integrimin e TIK, si dhe mbështetjen e politikave të TIK në shkolla.

Janë trajnuar 30 % e mësuesve të arsimit para universitar në përdorimin e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si dhe integrimin e mjeteve TIK në mësimdhënie. Janë trajnuar 25 % e drejtuesve të shkollave arsimit para universitar në përdorimin e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si dhe mbështetjen e politikave të integrimit të mjeteve TIK në mësimdhënie.



Grafiku 5: Numri i mësuesve të trajnuar

6. ZHVILLIMI I NJË KURRIKULE BASHKËKOHORE NË FUSHËN E TIK

Duke filluar nga viti 2005 TIK-u ka filluar të jetë prioritet në sistemin arsimor, dhe ti jepet rëndësi e veçantë në kurrikulat shkollore. Për t'ju përgjigjur kësaj nisme janë hartuar në të njëjtat vite programet e para në të cilat lënda e TIK-ut filloi të jetë si lëndë më vete në klasën e 7-të. Me zhvillimin e shoqërisë së sotme, drejt një shoqërie digjitale, dhe kërkesat e nxënësve për të qenë më të përgatitur me aftësitë e shekullit të XXI, TIK-u lind si nevojë primare e arsimit. Nëse në vitet e mëparshme, të quheshe një mësues i mirë do të mjaftonte të ishte njohës i mirë i lëndës, në ditët e sotme një mësues i mirë është ai që di të menaxhojë mirë informacionin e gjetur në burimet e ndryshme informative. Për të arritur këtë objektiv MASH ka marrë nismën në reformimin e arsimit bazë. Me reformimin e kurrikulës është synuar zhvillimi i një kurrikule bashkëkohore në fushën e TIK-ut në arsimin parauniversitar me qëllim aftësimin e nxënësve në përputhje me standardet evropiane.

Së dyti, në reformimin e kurrikulës është synuar që nxënësit të përftojnë aftësi që u nevojiten nxënësve për të mësuarin gjatë gjithë jetës, po edhe të jenë më kritik dhe krijues në të përditshmen e tyre. Për të patur nxënës që duan të ndryshojnë po edhe të jenë të përgatitur për të qenë qytetare aktivë në zhvillimet dixhitale, TIK-u mendohet që do të fillojë si metodologji mësimdhënie në klasën e tretë, dhe si lëndë më vete në klasën e 4-rt.

7. BURIMET ALTERNATIVE TË MËSIMDHËNIES.

Burimi aktual dhe kryesor i procesit mësimor në arsimin para universitar është teksti shkollor. Për këtë arsye, mësuesit shpeshherë japin në mësim vetëm përmbajtjen e teksteve dhe nuk përdorin burime të tjera alternative. Ndjehet nevoja për futjen shkallë-shkallë të teksteve të

tjerë të referencës, duke filluar në këtë mënyrë me krijimin e bibliotekave në klasa. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në programet e arsimit para universitar është shumë i kufizuar, prandaj në shkolla duhet shqyrtuar mundësia e krijimit të bibliotekave me lidhje interneti. Po në të njëjtën kohë duhet përmendur që kemi edhe mësues që kanë filluar të krijojnë përmbajtje elektronike, po kemi edhe nxënës që ju pëlqen të krijojnë informacione elektronike.

Mund të përmendim rastin e talenteve, apo nxënësve që janë gjithnjë e më pranë botës informative. Po në të njëjtën kohë nxënësit përballen me vështirësinë e menaxhimit të informacionit. Para se të krijojmë përmbajtje dixhitale (*e-content*), është e rëndësishme që të krijojmë edhe përmbajtje dixhitale, se si nxënësit mund të menaxhojnë informacionet e shumëllojshme. Po në të njëjtën kohë, përmbajtja dixhitale do t'u vinte më shumë në ndihmë nxënësve nëse përzgjedhja e tij do të bëhej në varësi të moshës së nxënësve. Ndërsa mësuesit nëpërmjet përmbajtjes dixhitale mund të ndajnë ndërmjet tyre eksperiencat dhe praktikatat më të mira. Mund të themi, që krijimi i përmbajtjes dixhitale është sfida e radhës në fushën e arsimit, dhe prania e të gjithë aktorëve do të ishte çelësi i këtij suksesi.

8. SFIDAT DHE MASAT E PARASHIKUARA NGA QEVERIA SHQIPTARE NË TË ARDHMEN NË FUSHËN E INTEGRIMIT TË TIK NË SISTEMIN ARSIMOR.

Deri në ditët e sotme është bërë një përparim i madh në kuadër të integrimit të T.I.K, në sistemin arsimor. Duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo fushë ka filluar të zhvillohet gjatë dekadës së fundit, vlen të theksohet se ky sektor ka përparuar me ritme të shpejta. Megjithatë me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të situatës ende duhet të vijojë procesi i hartimit të politikave, planeve strategjike si dhe marrja e veprimeve apo masave konkrete në kuadër të aplikimit të T.I.K jo vetëm në menaxhimin e sistemit arsimor, por edhe gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies.. Në këto kushte, duhet të vijojë implementimi i rekomandimeve të “Planit të integrimit të TIK në arsim 2011-2013”, si dhe duhet të finalizohet Plani i Veprimit për integrimin e TIK në sistemin arsimor 2013-2020, plan i cili duhet të jetë në përputhje me të gjitha politikatat përfshirëse të shoqërisë së informacionit si dhe në përputhje me planin e veprimit “Shoqëri informacioni për të gjithë”. Proces i hartimit të këtyre dokumenteve strategjike duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe me bazë të gjerë konsultimit me të gjithë aktorët e sistemit, si dhe palët e interesuara si dhe në të njëjtën kohë duhet të shoqërohet paralelisht, me përshtatjen e kuadrit të duhur ligjor dhe standardeve në përputhje me parimet e aksesimit dhe përmbajtjeve dixhitale.

Në të njëjtën kohë, vlen të theksohet se reforma e mëtejshme në këtë fushë synohet të arrihet nëpërmjet marrjes së masave të caktuara në drejtime të ndryshme. Këto drejtime konsistojnë në kuadër të infrastrukturës së TIK në sistemin arsimor, trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve, zhvillimit dhe të përcaktimit të standardeve, apo aplikimit të praktikave më të mira. Këto masa duhet të shoqërohen me veprime konkrete të cilat duhet të jenë specifike dhe në përputhje me qëllimin e secilës masë të parashikuar.

Marrja e masave të mëtejshme në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së TIK në sistemin arsimor duhet të fokusohen te:

- *rritja e shpejtësisë së aksesit të internetit në shkolla dhe cilësisë së shërbimit;*
- *shtimi i laboratorëve të informatikës;*
- *pajisja me laptopë e mësuesve të informatikës;*
- *pajisja me laptopë dhe projektorë e klasave të sistemit para-universitar;*
- *pajisja me laboratorë për mësimin e gjuhëve të huaja;*
- *pilotimi i teknologjive arsimore në disa shkolla;*
- *krijimi i portalit të e-edukimit për zhvillim përmbajtje dixhitale dhe përdorimi të burimeve dixhitale në mbështetje të kurrikulave;*
- *përcaktimi i skemës për të maksimizuar përdorimin e laboratorëve kompjuterikë në shkolla për komunitetin: (i) zgjatja e orarit të shfrytëzimit; (ii) përdorimi i laboratorëve T.I.K në shkolla në fundjavë.*

Marrja e masave të mëtejshme në kuadër të trajnimit të mësuesve dhe kualifikimit të tyre duhet të fokusohen te:

- *trajnimet që duhet të planifikohen gjithnjë në përputhje me standardet profesionale të mësuesve dhe përmbajtja e tyre duhet të hartohet mbështetur në objektiva të qarta kompetencash.*
- *planifikimi vjetor i trajnimeve, i cili duhet të mbështetet në plane strategjike afatmesme kombëtare ose lokale, si dhe duhet të realizohet identifikimi shkencor i nevojave profesionale të mësuesve në nivel qendror ose lokal.*
- *trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit para-universitar në integrimin e TIK-ut në kurrikula;*
- *trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit para-universitar në integrimin e TIK-ut në kurrikula nëpërmjet të mësuarit bazuar në projekte;*
- *ngritja e qendrës kombëtare të trajnimeve TIK dhe zhvillimi profesional i mësuesve në qendrat e ngritura.*

Marrja e masave të mëtejshme në kuadër të zhvillimit të një kurrikule bashkëkohore në fushën e TIK. Implementimi i kurrikulës së re të rishikuar TIK për klasat 1-12:

- *Zhvillimi i përmbajtjeve dixhitaleve (e-content) në sistemin arsimor;*
- *Aplikimi i TIK-ut si metodologji mësimdhënie nga klasa 1 deri në klasën e tretë;*

- *Zhvillimi i lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si lëndë e veçantë nga klasa 4-9;*
- *Integrimi ndërkurrikular i TIK-ut në sistemin arsimor parauniversitar.*

Marrja e masave të mëtejshme në kuadër të zhvillimit dhe të përcaktimit të standardeve:

- *Zbatimi i standardeve TIK për nxënësin, mësuesin, drejtuesit e shkollave;*
- *Përcaktimi i skemave/standardeve të përgatitjes/certifikimit të Specialistit të Teknologjisë në Edukim;*
- *Ngritja e grupit të punës për përcaktimin e standardeve të Specialistit të Teknologjisë në edukim;*
- *Përcaktimi i skemave të përgatitjes/kurrikulës/certifikimit të specialistit të Teknologjisë në Edukim.*
- *Bashkëpunimi me IAL-të për përgatitjen e specialistit të Teknologjisë në Edukim.*
- *Bashkëpunimi me institucionet trajnuese private për përgatitjen e specialistit të Teknologjisë në Edukim.*

Rritja e bashkëpunimit me aktorët privat, në kuadër të aplikimit të praktikave më të mira mbi integrimin e TIK në sistemin arsimor:

- *Aplikimi i projekteve pilot për rritjen e aksesit për përdorimin e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit;*
- *Implementimi i “e-book reader” si projekt pilot në disa shkolla në zona të ndryshme të vendit me pak të favorizuara;*
- *Përhapja e mëtejshme e njohurive mbi implementimin e moduleve me përmbajtje trajnimesh që mund të përdoren lokalisht në laboratorët kompjuterikë të shkollave ose për zhvillimin e trajnimeve on-line;*
- *Zhvillimi i materialeve dixhitale për kurrikulat e arsimit parauniversitar.*
- *Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mësues - nxënës në përdorimin e TIK në sistemin arsimor dhe organizimi në të ardhmen të nismave të kësaj natyre.*
- *Realizimi i udhëzuesve metodik për zbatimin e T.I.K-ut në klasë.*

9. PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E TIK NË SISTEMIN ARSIMOR 2013-2020

Për sa i përket Planit të Veprimit për integrimin e TIK në sistemin arsimor 2013-2020, si dhe formës së tij (struktura), duhet të mbahet parasysh se tashmë Qeveria Shqiptare me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 692, datë 10.11.2005, ka miratuar dokumentin “Konsolidimi i një Sistemi Planifikimi të Integruar në Shqipëri”. Ky sistem përfaqëson një grup parimesh funksionale për të garantuar që procesi i planifikimit strategjik dhe i zbatimit të politikave nga ana e Qeverisë të kryhet në mënyrë koherente dhe të integruar. Në këtë kuadër institucioni përgjegjës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës gjatë zhvillimit të procese planifikuese duhet të kenë parasysh këtë grup parimesh funksionale.

Në mbështetje të Urdhrit Nr. 93, datë 07.08.2012, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë: “Për përgatitjen e Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale Kombëtare për periudhën 2013-2020, si dhe dokumenteve strategjike sektoriale 2013-2020, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2013-2020”, ky plan veprimi mund të jetë pjesë e Strategjisë Sektoriale për arsimin dhe kërkimin shkencor, ose të hartohet në formën e një dokumenti të posaçëm sektorial strategjik sipas pikës 3, të Urdhrit 93/2012. Ky dokument duhet të miratohet me Urdhër Ministri.

Struktura e këtij dokumenti strategjik sektorial duhet të riformulohet si më poshtë vijon:

- *Kapitulli 1: Kushtet Aktuale;*
- *Kapitulli 2: Vizioni, Politikat dhe Qëllimet e politikave;*
- *Kapitulli 3: Objektivat e Politikës dhe produktet madhore;*
- *Kapitulli 4: Burimet Financiare;*
- *Kapitulli 5: Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese.*
- *Kapitulli 6: Plani i veprimit*

Ku dokument strategjik sektorial duhet të jetë në proces të vazhdueshëm shqyrtimi dhe rishikimi. Gjithashtu, edhe plani i veprimit i integruar, i cili rifreskohet çdo vit, do të shërbejë si një bazë e mirë monitorimi dhe ushqyes për nevojat për financime nga buxheti i shtetit apo përmes financimeve të huaja.

Në vijim të këtij dokumenti, duke mbajtur në konsideratë objektivat dhe masat të cilat janë zbatuar në kuadër të integrimit të T.I.K në sistemin arsimor, si dhe sfidat në të ardhmen për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj fushe, për efekt ilustrimi pasqyrohet modeli i plani i të veprimit për integrimin e T.I.K në sistemin arsimor 2013-2020.

PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E TIK NË SISTEMIN ARSIMOR 2013-2020

Nr.	Objektivat specifike	Veprimet që duhen ndërmarrë	Koha e realizimit	Burimet/Buxheti 000 lekë	Institucionet përgjegjëse dhe partnere	Mekanizmat monitorues dhe vlerësues
Prioriteti strategjik 1 Përmirësimi i infrastrukturës së T.I.K në sistemin arsimor						
1.1	Rritja e shpejtësisë së aksesit të internetit në shkollë dhe cilësisë së shërbimit.	Rritja e gjerësisë së brezit të shërbimit të internetit në shkollë. Ndërgjegjësimi i mësuesve, nxënësve, prindërve në lidhje me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.	2013-2020	PBA	MASH	- Gjerësia e brezit - Numri i shkollave - Afati i realizimit - Numri i mësuesve - Numri i nxënësve - Numri i prindërve - Numri i aktivitetëve - Afati i realizimit - Niveli bashkëpunimit
1.2	Rritja e nivelit të investimeve në kuadër të pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.	Pajisja me laptopë e mësuesve të informatikës. Pajisja me laptopë dhe projektorë e klasave të sistemit para-universitar. Ndërtimi i laboratorëve të informatikës. Ndërtimi i laboratorëve për mësimin e gjuhëve të huaja.	2013-2020	PBA PBA PBA PBA	MASH	- Numri i laptopëve - Numri i mësuesve - Afati i realizimit - Numri i laptopëve - Numri i projektorëve - Numri i klasave - Afati i realizimit - Numri i laboratorëve - Afati i realizimit - Numri i laboratorëve - Afati i realizimit
1.3	Zhvillimi i platformave kompjuterike të edukimit në mbështetje të rritjes së cilësisë /mësim nxënies dhe vënies në përdorim e tyre.	Krijimi i portalit të e-edukimit për zhvillim përbajtje dixhitale dhe përdorimi të burimeve dixhitale në mbështetje të kurrikulave.	2013-2020	PBA	MASH	- Ndërtimi i portalit dhe funksioni i tij. - Numri i përbajtjeve dixhitale. - Afati i realizimit.

1.4	Pilotimi i teknologjive arsimore në disa shkolla.	Pilotimi i projekteve me teknologjitë e avancuara (lexuesit digjitalë, telefonat inteligjentë.	2013-2020	PBA	MASH	- Numri i projekteve - Numri i pajisjeve - Afati i realizimit
1.5	Maksimizimi i përdorimit të laboratorëve të T.I.K nga komuniteti.	Përcaktimi i skemës për të maksimizuar përdorimin e laboratorëve kompjuterikë në shkolla për komunitetin.	2013-2020	PBA	MASH	- Hartimi i skemës së përdorimit të laboratorëve - Afati i realizimit
Prioriteti strategjik 2						
Rritja e nivelit të kualifikimit dhe trajnimit të mësuesve						
2.1	Identifikimi shkencor i nevojave profesionale të mësuesve në nivel qendror ose lokal.	Planifikimi vjetor i trajnimeve, mbështetur në plane strategjike afatmesme kombëtare ose lokale.	2013-2020	PBA	MASH	- Dokumenti planifikimit - Afati i realizimit
		Planifikimi i trajnimeve në përputhje me standardet profesionale të mësuesve, si dhe mbështetur në objektiva të qarta kompetencash.	2013-2020	PBA	MASH	- Dokumenti planifikimit - Afati i realizimit
2.2	Rritja e numrit të mësuesve të trajnuar të sistemit të arsimit para-universitar në integrimin e TIK-ut.	Trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit para-universitar në kurrikula.	2013-2020	PBA	MASH	- Numri i trajnimeve - Numri i mësuesve të trajnuar - Afati i realizimit
		Trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit para-universitar në integrimin e TIK-ut në kurrikula bashkuar bazuar në projekte.	2013-2020	PBA	MASH	- Numri i trajnimeve - Numri i mësuesve të trajnuar - Afati i realizimit
		Përdorimi i metodave online për zhvillim profesional të mësuesve në fushën TIK dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve në këtë fushë.	2013-2020	PBA	MASH	- Numri i metodave - Numri i aktivitetëve; - Numri i mësuesve të përfshirë në proces; - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit

Prioriteti strategjik 3 Zhvillimi i një kurrikule bashkëkohore në fushën e TIK							
				2013-2020	PBA	MASH	- Numri i kurrikulave - Afati i realizimit
				2013-2020	PBA	MASH	- Numri i kurrikulave - Afati i realizimit
				2013-2020	PBA	MASH	- Numri i kurrikulave - Numri i përmbajtjeve dixhitale - Afati i realizimit
				2013-2020	PBA	MASH	- Hartimi i kurrikulës dhe tekstit mësimor - Afati i realizimit
Prioriteti strategjik 4 Zhvillimi dhe përcaktimi i standardeve							
				2013-2020	PBA	MASH	- Hartimi i standardeve - Afati i realizimit
				2013-2020	PBA	MASH	- Hartimi i Urdhrit për ngritjen e grupit të punës - Afati i realizimit

							Përcaktimi i skemave të përgatitjes/kurrikulës/certifikimit të specialistit të Teknologjisë në Edukim.			PBA			MASH		- Hartimi i standardeve - Afati i realizimit
							Bashkëpunimi me IAL-të për përgatitjen e specialistit të Teknologjisë në Edukim.			PBA			MASH		- Numri i dokumenteve të hartuara - Numri i aktiviteteve - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit
							Bashkëpunimi me institucionet trajnuese private për përgatitjen e specialistit të Teknologjisë në Edukim.			PBA			MASH		- Numri i dokumenteve të hartuara - Numri i aktiviteteve - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit
Prioriteti strategjik 5															
Aplikimi i praktikave më të mira mbi integrimin e TIK në sistemin arsimor															
							Aplikimi i projekteve pilot për rritjen e aksesit për përdorimin e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit			PBA			MASH		- Numri i dokumenteve të hartuara - Numri i projekteve - Numri i aktiviteteve - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit
							Implementimi i "e-book reader" si projekt pilot në disa shkolla në zona të ndryshme të vendit me pak të favorizuara.			PBA			MASH		- Numri i aktiviteteve - Niveli i shkollave - Afati i realizimit
							Përhapja e mëtejshme e njohurive mbi implementimin e moduleve me përmbajtje trajnimesh që mund të përdoren lokalisht në laboratorët kompjuterikë të shkollave ose për zhvillimin e trajnimeve on-line.			PBA			MASH		- Numri i trajnimeve - Numri i shkollave - Afati i realizimit
4.2															
5.1							Zhvillimi i iniciativave të përbashkëta me aktorët e interesuar në kudër të konceptimit dhe zhvillimit të praktikave më të mira në lidhje me infrastrukturën, përmbajtjeve dixhitale, kualifikimit apo trajnimin të mësuesve si dhe hartimin apo publikimin e materialeve të shkruara etj.								

							<ul style="list-style-type: none"> - Numri i materialeve - Afati i realizimit
							<ul style="list-style-type: none"> Numri i dokumenteve të hartuara - Numri i projekteve - Numri i aktiviteteve - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit
							<ul style="list-style-type: none"> - Numri i dokumenteve të hartuara - Niveli i bashkëpunimit - Afati i realizimit